

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “Bermon Ndertim” shpk,**

Ne Tirane, sot ne date 19.Qershor.2020 :  
Me cilesine e “ortakut te vetem themelues” :

- **z.Robert Bano**, i biri Kujtimi-it,lindur me date 01.09.1972 ne Vendresh, Skrapar dhe banues ne Rr “Aleksander Moisiu”,ish-Kinostudio, Nr-12,(prane Hotel Bermon dhe TV Klan),Tirane,i identifikuar me leternjoftimin me nr personal H20901230W ;  
me vullnet të lire të plote e të sinqerte, kame redaktuar këtë statut ne respekt te :  
Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,  
Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “,  
Ne ligjin “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, ka themeluar një Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **“Bermon Ndertim” shpk**, (me poshte e quajtur “ Shoqeria ”) .

**KAPITULLI I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

*Neni 1*  
*Emertimi*

Shoqeria gezon emerin **“Bermon Ndertim” shpk** dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , me poshte e quajtur “Shoqeria”).  
Shoqeria miraton dhe perdor logon,vulen,shumen e kapitalit te nenshkruar,NIPT-in dhe cdo te dhene tjeter qe e identifikon ate ne mardhenie me te trete

*Neni 2*  
*Personaliteti juridik*

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **“Bermon Ndertim” shpk** është një shoqëri tregtare, e krijuar sipas ligjit te shoqerive tregtare dhe si e tille nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbalon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

*Neni 3*  
*Selia*

Shoqeria e ka seline ne Tirane ,ne adresen , Rr “Aleksander Moisiu”,ish-Kinostudio, Nr-12,(prane Hotel Bermon dhe TV Klan),Tiranë .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te vetem .



Neni 4  
Objekti i veprimitarise

Shoqeria do te operoj ne fushen e ndertimeve civile te te gjithe llojeve dhe natyrave,zbatim,projektim,prodhime betoni dhe te tjera te ngashme,perpunim dhe tregtim inerte inventar, linja dhe paisje te ndryshme dhe materiale ndertimi,investim,pjesmarrje dhe ndertim te veprave te infrastrukture publike dhe private,rruge,hekurudha,ujsjelles kanalizime,hidrocentrale.

Pjese e aktivitetit te shoqerise do jete edhe,perpunimi,instalimi,prodhimi i mallrave industriale,shrebime te punimeve per infrastrukturen ndertimore,energjite, sherbime te agjentit ,subagjentit ne shitje blerje pasurie te luajtshme dhe te paluajtshem dhe brokerit per mardhenie kontraktimi midis paleve dhe mardhenie financiare,leasing,qeradhenie-qeramarrje, konsulence, marketing, export-import,sherbime transporti per nevoja te veta dhe per te trete si dhe cdo aktivitet te lejuar nga ligji.

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetence e mbledhjes së Ortakut te vetem te shoqërisë

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET**

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i pataksueshem i shoqerise eshte per shumen 300.000,00( treqinde mijë) euro ose ekivalenti ne leke, 1(nje) kuote.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga ortaku i shoqerise :

**z. Robert Bano**, zoteres i 1(nje) kuota me vlere te pergjithshme 300,000 euro, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise .

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut,mund të jetë në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) edhe në para (cash).

Neni 7  
Zmadhimi dbe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një audituesi per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet audituesve ligjor, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së Ortakut te Vetem të thirrur për të marrë vendim rrëth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar me ligje apo te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi

është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

## Neni 8

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpermjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - c) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë,

Personi që kalon kuo të dha ai që e fiton atë përcjicjen në mënyrë solidare ndaj shërbimit të tij.

Personi që ka qenë kuotet e njejsh me përgjigjen ne menyre sondare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

## KAPITULLI III ORTAKU I VETEM, ADMINISTRATORET DHE AUDITUESIT LIGJOR

Neni 9  
Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

*Ortaku i vetem, vendos për çështje si :*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të audituesve ligjore;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarës;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.  
Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Vendimet e ortakut janë të detyrueshme për zbatim nga ana e dreitimit të shoqërisë.

Neni 10  
Administrimi

Administrator i shoqerise emerohet ne detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte riparteritje. Administratori i pare i shoqerise do jete z.Robert Bano,lindur me date 01.09.1972 ne Vendresh, Skrapar dhe banues ne Rr “Aleksander Moisiu”,ish-Kinostudio, Nr-12,(prane Hotel Bermon dhe TV Klan),Tirane,i identifikuar me leternjoftimin me nr personal H20901230W

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 11  
Kompetencat

*Administratori ka të drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmiratuese, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si dhe te publikoje cdo vendim qe ka efekte per shoqerine;
  - e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratuar e shoqërisë tregtare;
- Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat përmiratuar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrrethanat me përfjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Administratori eshte i detyruar te zbatoj venimin e ortakut te vetem,kjo edhe ne rastet kur mendimi i tij eshte i ndryshem

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12  
Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, përmiratuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17

- e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjesid;
  - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- i kthen ortakut kontributet;
  - i paguan ortakut interesa apo dividendë;
  - i shpérndan aktivet shoqërisë;
  - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - jep kredi.

## KAPITULLI V

### DIVIDENTI, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË, MOSMARVESHJET

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton pasqyrat financiare te paraqitur nga Administratori dhe nga audituesit ligjore ne se kerkohet me ligje apo ka te emeruar nga ortaku i shoqerise.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos per shperndarjen e dividentit pas miratimit te pasqyrave financiare dhe ne cdo kohe qe e shikon te arsyeshme.Oratku krijon rezerva statuore ne masen 10% te kapitaleve te veta, rezerva ligjore ne masen 10% te kapitalit te shoqerise dhe rezerva per kerkime dhe studime ne masen 5% te kapitaleve te veta, pjesa e mbetur pa perdorur destinohet ne postin rezerva te tjera,keto pasi te jene zbritur humbjet e mbartura nga vitet e meparshme, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

*Shperndarja ose prishja e shoqerise*

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper ”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 16

*Likuidimi*

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 17

*Mosmarreveshjet*

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e trethit Gjyqesor,Tirane.

Shoqëria “**Bermon Ndertim**” shpk  
ORTAKU I VETEM

**Robert BANO**

